



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 37, datë 08.09.2022

CAKTIMIN E EKSPERTIT KONTABËL NË LIDHJE ME HARTIMIN E AKTIT TË EKSPERTIMIT QË KA LIDHJE ME VERIFIKIMIN E KRITERIT TË PASURISË PËR KANDIDATIN GENT IBRAHIMI, PËR VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 13.01.2022

Në bazë të nenit 235 të Ligjit nr 115/ 2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe pikës 69 dhe 70 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në mbledhjen e tij të datës 08.09.2022,

V E N D O S I :

1. Të lejojë kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin Gent Ibrahim, i cili, kandidon për vendin vakant për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 13.01.2022.
2. Të caktojë si ekspert kontabël për hartimin e aktit të ekspertimit, ekspertin kontabël të licencuar, znj. Valbona Kraja.
3. Të caktojë datën 16.09.2022 si datë për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me qëllim përcaktimin e detyrave ekspertit kontabël të licencuar.
4. Të bëhet njoftimi i ekspertit kontabël të licencuar nj. Valbona Kraja, si dhe kandidati Gent Ibrahim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ

